



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.734/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Përparim Shalës, kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, të paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të dt.03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHEN** të pabazuara apelet Anr.734/2021, Anr.735/2021 dhe Anr.736/2021, të paraqitura nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Përparim Shala, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, e paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të dt.03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Vendvotimet nr.0328E/01D, 0309E/01R.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelet me datën 03.11.2021, nga Përparim Shala, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilat pretendon se i mungojnë votat në VV 0328E/01D dhe 0309E/01R.

Në apelin Anr.734/2021 pretendohet se me datë 30.10.2021 në vendvotimin 0328E/01D është bërë rinumërimi i votave dhe rezultati i tij në numrin 5 ka qenë 177 e cila siç thekson është përshkruar në formular, mirëpo shihet se është intervenuar dhe është bërë 157 dhe mendon se është dëmtuar për 20 vota.

Në apelin Anr.735/2021, pretendon se në vendvotimin 0307E/01R, ka votuar për kandidatin Përparim Shala, kur është bërë shpallja e rezultatit ka rezultuar se në atë vendvotim nuk është vota e ankuesit që kisha votuar. në formularin e votave të kandidatëve shihet qartë përshkrimi i votave 6 e ndryshuar 0 dhe kërkon nga PZAP-i ti merren parasysht apelet lidhur me këto Vend Votime.

Në apelin Anr.736/2021 pretendon se në vendvotimin 0309E/01R në formularin e votave të kandidatëve shihet qartë përshkrimi i votave 6 e ndryshuar 0 dhe kërkon nga PZAP-i ti merren parasysht apelet lidhur me këto Vend Votime.

Parashtresuesi i apeleve ka bashkangjitur Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR) dhe Formularët e Rezultateve për Kandidat (FRK) për Vend Votimet e cekura në apele.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.734/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim, i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apelet janë të pabazuara**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë në Kuvendin Komunal në Komunën e Drenasit, Përparim Shala, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), brenda afatit ligjor, ka parashtruar Apelet ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në nr.0328E/01D, 0309E/01R, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, me rastin e vendosjes së apelit ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga apeluesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i apelit se në vendvotimin me numër 0328E/01D i njëjti posedon 157 vota dhe në vendvotimin 0309E/01R i njëjti posedon 0 vota.

Në fletëvotimet që janë rinumëruar del se kandidati me numër 5 nga subjekti politik PDK, ka fituar 157 vota në vendvotimin me numër 0328E/01D të cilat janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK dhe 0 vota i posedon në vendvotimin me numër 0309E/01R, dhe se të njëjtat vota iu janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 734/2021 më datën 05.11.2021.

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 18 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

